



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

URDHËR

Nr. 315, Datë 24.8.2017

PËR

**PROCEDURAT E LËSHIMIT TË VËRTETIMIT TEKNIK PËR SUBJEKTET QË KRYEJNË
AKTIVITET NË FUSHËN E PËRPUNIMIT, TRANSPORTIMIT DHE TREGTIMIT TË
NAFTËS DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 12/1, 13, 14, 15, 16 dhe 23 të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin, tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 5 i ligjit Nr. 9876, datë 14.02.2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lendeve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, të ndryshuar, VKM Nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës , gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, VKM Nr. 755, datë 12.11.2014 “Për përcaktimin e procedurave e të kushteve për dhënien e “licencës së përpunimit” për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës” dhe VKM Nr. 19, datë 14.1.2015 “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”, kreut IV VKM Nr. 491 date 19.07.2017 “Për përcaktimin e rregullave të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”

URDHËROJ

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.

1. Vërtetimi Teknik lëshohet për:

1. respektimin e normave dhe të kushteve teknike në instalimet teknologjike (terminale detare dhe hekurudhore, depozita, magazina për vajra lubrifikantë, stacione karburanti, njësi të lëndës djegëse)

2. miratimin e Kartës Teknologjike

3. miratimin e projektit teknologjik

4. miratimin e skemës teknologjike

për të gjitha subjektet, objekt i ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin ,transportimin, tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar dhe ligjit Nr. 9876, datë 14.02.2008

“Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lendeve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, i ndryshuar dhe jepet nga Organi i miratuar i vlerësimit të konformitetit (OMVK), i pajisur me aktin e posaçëm të miratimit për ushtrimin e këtij aktiviteti. OMVK duhet të disponojë stafin e nevojshëm të kualifikuar me eksperiencë jo më pak se pesë vjet në fushën e këtyre instalimeve, dhe të ketë edhe staf të pajisur me lejen profesionale në përputhje me dispozitat e VKM 551/2015.

2. Formati tip i Vërtetimit Teknik përmban, por pa u kufizuar:

- Emrin e subjektit.

- Llojin e Veprimtarisë.

- Vendndodhjen e instalimit, projektin teknik e teknologjik të tij, si dhe normat, kushtet dhe rregullat teknike të zbatueshme për këtë instalim.

- Kategorinë e produkteve dhe markën që prodhohen apo depozitohen.

- Kapacitetin prodhues apo depozitues.

- Afatin e Vlefshmërisë të tij.

II. Procedura dhe dokumentacioni.

A. Për tu pajisur me Vërtetim Teknik, për herë të parë, subjekti paraqet pranë Organit të miratuar të vlerësimit të konformitetit në përputhje me piken 1 të kreut II të VKM 491 datë 19.07.2017, kërkesën të shoqëruar me këto dokumente.

1. - Shoqëritë e tregtimit më shumicë për respektimin e normave dhe të kushteve teknike në instalimet teknologjike, përfshirë dhe ato të prodhimit të biokarburanteve.

a. Ekstrakti i QKR –së.

b. Vërtetimi i pronësisë ose kontrata e marrjes me qira të instalimeve teknologjike, depozitave, magazinës së vajrave që do të përdorë subjekti. Afati i kontratës të qirasë të jetë jo më i vogël se afati i vlefshmërisë së Vërtetimit Teknik.

- c. Leje përdorimit të objektit lëshuar nga organi përgjegjës për qëllimin për të cilin lëshohet vërtetimi teknik.
- d. Projekti Teknologjik i pajisur me vërtetimin e përputhshmërisë së miratuar nga një organ i miratuar i vlerësimit të konformitetit, i miratuar për inspektimin e projekteve teknike e teknologjike dhe lëshimin e vërtetimit të përputhshmërisë në përputhje me dispozitat e ligjit 32/2016 “Për sigurinë e punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.
- e. Vërtetimi për kalibrimin e depozitave nga organet e metrologjisë dhe kalibrimit.
- f. Projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi i miratuar nga institucioni përgjegjës publik për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.
- g. lejen përkatëse mjedisore për ushtrimin e veprimtarisë.
- h. Certifikatat e konformitetit për secilin nga produktet/pajisjet/instalimet që kanë detyrimin e kryerjes së inspektimeve teknike periodike, në përputhje me rregullat dhe rregulloret teknike në fuqi. Certifikata e konformitetit duhet të paraqitet edhe për rastet kur aplikohen dispozitat e pikës 2 të nenit 9 të Ligjit 32/2016.
- i. Projektin e certifikuar të mbrojtjes katodike të këtyre instalimeve, si dhe certifikatën e konformitetit të sistemit të mbrojtjes katodike.
- j. Dokumentacionin i cili provon se punonjësit që kryejnë punë pranë këtyre instalimeve janë të pajisur me certifikatat e dëshmive të aftësisë profesionale, sipas përcaktimeve të ligjit 32/2016 dhe akteve ligjore në zbatim të tij.
- l. Dokumentacioni i cili provon kryerjen sipas programit të mirëmbajtjes dhe pastrimit të instalimeve dhe sistemeve depozituese, sipas përcaktimeve të pikës 2 të Kreut III të VKM 491/2019. Kjo pike është e aplikueshme nga viti i dytë i hyrjes në fuqi të kësaj rregullore.
- k. Dokumentin që provon regjistrimin e pajisjeve/instalimeve, makinerive dhe çdo lloj produkti/pajisje/instalimi i cili ka detyrimin e regjistrimit në përputhje me rregullat teknike dhe legjislativën në fuqi pranë strukturës përgjegjëse.

2. - Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësive të lëndës djegëse respektimin e normave dhe të kushteve teknike.

- a. Ekstrakti i QKR –së.
- b. Vërtetimi i pronësisë ose kontrata e marrjes me qira të instalimeve teknologjike, depozitave, magazinës së vajrave që do të përdorë subjekti. Afati i kontratës të qirasë të jetë jo më i vogël se afati i vlefshmërisë së Vërtetimit Teknik.
- c. Leje përdorimit të objektit lëshuar nga organi përgjegjës për qëllimin për të cilin lëshohet vërtetimi teknik.

d. Projekti Teknologjik i pajisur me vërtetimin e përputhshmërisë së miratuar nga një organ i miratuar i vlerësimit të konformitetit, i miratuar për inspektimin e projekteve teknike e teknologjike dhe lëshimin e vërtetimit të përputhshmërisë në përputhje me dispozitat e ligjit 32/2016 “Për sigurinë e punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.

e. Vërtetimi për kalibrimin e depozitave nga organet e metrologjisë dhe kalibrimit.

f. Projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi i miratuar nga institucioni përgjegjës publik për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.

g. Lejen përkatëse mjedisore për ushtrimin e veprimtarisë.

h. Certifikatat e konformitetit për secilin nga produktet/pajisjet/instalimet që kanë detyrimin e kryerjes së inspektimeve teknike periodike, në përputhje me rregullat dhe rregulloret teknike në fuqi. Certifikata e konformitetit duhet të paraqitet edhe për rastet kur aplikohen dispozitat e pikës 2 të nenit 9 të Ligjit 32/2016.

i. Projektin e certifikuar të mbrojtjes katodike të këtyre instalimeve, si dhe certifikatën e konformitetit të sistemit të mbrojtjes katodike.

j. Dokumentacionin i cili provon se punonjësit që kryejnë punë pranë këtyre instalimeve janë të pajisur me certifikatat e dëshmitë të aftësisë profesionale, sipas përcaktimeve të ligjit 32/2016 dhe akteve ligjore në zbatim të tij.

l. Dokumentacioni i cili provon kryerjen sipas programit të mirëmbajtjes dhe pastrimit të instalimeve dhe sistemeve depozituese, sipas përcaktimeve të pikës 2 të Kreut III të VKM 491/2019. Kjo pike është e aplikueshme nga viti i dytë i hyrjes në fuqi të kësaj rregullore.

k. Dokumentin që provon regjistrimin e pajisjeve/instalimeve, makinerive dhe çdo lloj produkti/pajisje/instalimi i cili ka detyrimin e regjistrimit në përputhje me rregullat teknike dhe legjislacionin në fuqi pranë strukturës përgjegjëse.

3. - Rafineritë e përpunimit të naftës bruto dhe impiantet e përpunimit të nënprodukteve të saj për miratimin e kartës teknologjike, projektit dhe skemës teknologjike

a. Ekstrakti i QKR –së.

b. Vërtetimi i pronësisë ose kontrata e marrjes me qira të instalimeve teknologjike, depozitave, magazinës së vajrave që do të përdorë subjekti. Afati i kontratës të qirasë të jetë jo më i vogël se afati i vlefshmërisë së Vërtetimit Teknik.

c. Leje përdorimit të objektit lëshuar nga organi përgjegjës për qëllimin për të cilin lëshohet vërtetimi teknik.

d. Projekti Teknologjik i pajisur me vërtetimin e përputhshmërisë së miratuar nga një organ i miratuar i vlerësimit të konformitetit, i miratuar për inspektimin e projekteve teknike e

teknologjike dhe lëshimin e vërtetimit të përputhshmërisë në përputhje me dispozitat e ligjit 32/2016 “Për sigurinë e punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.

- e. Vërtetimi për kalibrimin e depozitave nga organet e metrologjisë dhe kalibrimit.
 - f. Projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi i miratuar nga institucioni përgjegjës publik për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi.
 - g. Lejen përkatëse mjedisore për ushtrimin e veprimtarisë.
 - b. Vërtetimi i pronësisë ose kontrata e marrjes me qira të sheshit të ndërtimit.
 - c. Karakteristikat fiziko – kimike të lëndës së parë dhe nënproduktet e përfituar nga përpunimi.
 - d. Projekti Teknologjik i detajuar, i hartuar nga persona fizike apo juridik të licencuar sipas fushës përkatëse.
 - e. Karta teknologjike me parametrat e projektuar të saj, e miratuar nga një organ i miratuar i vlerësimit të konformitetit për certifikim të kartave teknologjike.
 - f. Skema tekniko-teknologjike e funksionimit të instalimit
 - g. Bilanci material dhe normativat e konsumit të lëndëve ndihmëse dhe reagjentëve.
 - h. Standardet e nënprodukteve që do të prodhohen.
 - h. Certifikatat e konformitetit për secilin nga produktet/pajisjet/instalimet që kanë detyrimin e kryerjes së inspektimeve teknike periodike, në përputhje me rregullat dhe rregulloret teknike në fuqi. Certifikata e konformitetit duhet të paraqitet edhe për rastet kur aplikohen dispozitat e pikës 2 të nenit 9 të Ligjit 32/2016.
 - i. Projektin e certifikuar të mbrojtjes katodike të këtyre instalimeve, si dhe certifikatën e konformitetit të sistemit të mbrojtjes katodike.
 - j. Dokumentacionin i cili provon se punonjësit që kryejnë punë pranë këtyre instalimeve janë të pajisur me certifikatat e dëshmimeve të aftësisë profesionale, sipas përcaktimeve të ligjit 32/2016 dhe akteve ligjore në zbatim të tij.
 - l. Dokumentacioni i cili provon kryerjen sipas programit të mirëmbajtjes dhe pastrimit të instalimeve dhe sistemeve depozituese, sipas përcaktimeve të pikës 2 të Kreut III të VKM 491/2019. Kjo pike është e aplikueshme nga viti i dytë i hyrjes në fuqi të kësaj rregullore.
 - k. Dokumentin që provon regjistrimin e pajisjeve/instalimeve, makinerive dhe çdo lloj produkti/pajisje/instalimi i cili ka detyrimin e regjistrimit në përputhje me rregullat teknike dhe legjislacionin në fuqi pranë strukturës përgjegjëse.
- B.** Për rinovimin vjetor të Vërtetimit Teknik, subjekti paraqet kërkesën të shoqëruar me dokumentacionin përkatës për çdo ndryshim të mundshëm të kushteve fillestare mbi të cilat

është dhënë vërtetimi teknik, si dhe për secilin rast dhe siguracionin e vlefshëm për dëmet që mund të shkaktohen palëve të treta nga ushtrimi i aktivitetit.

- C. ISHTI do të vendose në dispozicion të OMVK të miratuara për këtë aktivitet, të gjithë dokumentacionin teknik të arshivuar ndër vite, në mënyrë që të njihen me të gjitha aspektet tekniko ligjore lidhur me këto instalime gjatë fazës së vlerësimit të kërkesave për rinovimin e vërtetimeve teknike të tyre.

III. Shqyrtimi i kërkesës.

a. Kërkesa e subjektit paraqitet pranë OMVK së miratuar për këtë aktivitet, shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar sipas përcaktimeve në këtë rregullore, e cila pasi protokollohet, fillon të shqyrtohet nga organi përkatës i vlerësimit të konformitetit.

b. Evidentohet dokumentacioni konform kërkesave të përcaktuara në kapitullin II të këtij Urdhri sipas llojit të veprimtarisë dhe instalimit. Për rastet kur ka mangësi, subjektit i kërkohet zyrtarisht plotësimi i tyre brenda një afati 60 ditësh, ndërsa për rastet e rinovimit ky afat është jo më shumë se 30 ditë.

c. Pas plotësimit të dokumenteve të kërkuara, brenda një afati kohor prej 10 ditësh, kryhet kontrolli fizik, në terren, për:

- Respektimin e kushteve dhe normave teknike,
- Verifikimin e kapaciteteve fizike të deklaruar,
- Verifikime të tjera teknike dhe ambientale sipas rastit

d. Kur nga kontrolli në terren rezulton se respektohen kushtet dhe normat teknike, si dhe çdo e dhënë tjetër e deklaruar nga subjektet, nëpërmjet dokumenteve të dorëzuar, plotësohet Akti i Kontrollit. Në rastin kur nga kontrolli rezulton se nuk plotësohen normat dhe kushtet teknike, subjektit i lihen detyra për zbatim si dhe afatet kohore përkatëse për plotësimin e dokumentacionit. Në çdo rast ky afat kohor nuk mund të jete më shumë se 30 ditë.

e. Nëse nuk plotësohen afatet kohore sipas pikës “d” atëherë subjekti duhet të bëjë aplikim të ri.

f. Formulari tip i vërtetimit teknik, i përgatitur në katër kopje, shoqëruar me dokumentacionin sipas kapitullit II të këtij Urdhri së bashku me Aktin e Kontrollit, përcillen për miratimin përfundimtar prej përfaqësuesit teknik dhe atij ligjor të organit të miratuar të vlerësimit të konformitetit.

g. Një kopje e Formularit tip të Vërtetimit Teknik i jepet subjektit, një kopje bashkë me dokumentacionin shoqëruar mbahet në arshivën e organit të miratuar, një kopje dërgohet në MEI dhe një kopje dërgohet në ISHTI.

h. OMVK e miratuara për këtë aktivitet, do të raportojnë në mënyrë të rregullt mujore mbi gjithë aplikimet e paraqitura prej subjekteve, si dhe statusin e aplikimit lidhur me miratimin e certifikatës së vërtetimit teknik përkatës, refuzimin dhe arsyet përkatëse, apo plotësimet e nevojshme që subjekti duhet të bëjë për tu pajisur me vërtetimin teknik dhe afatet për plotësimin e këtyre kërkesave.

i. Për çdo konstatim të shkeljeve prej subjekteve të kushteve tekniko ligjore të ushtrimit të aktivitetit, njoftohet menjëherë MEI dhe ISHTI, ku ky i fundit merr masat e menjëhershme sanksionuese në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

IV. Urdhri Nr. 76 datë 18.03.2015 shfuqizohet, dhe ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Ngarkohet ISHTI, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit Hidrokarbur dhe Drejtoria e Industrisë dhe Standardeve Teknike, për ndjekjen e zbatimit të dispozitave të këtij Urdhri.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI

